

AIDA LAMAJ

FJALORI I NGJYRAVE NË LIGJËRIMIN FEMËROR

Në hapësirën e informacioneve që marrim në kohën e sotme na vjen bindëse teza se kushtëzimet shoqërore mbi të folurin, gjejnë zbatim jo vetëm ndaj ndryshorit të gjinisë, por edhe ndaj sjelljes që shfaqin individët a grupet e bashkësive në përgjithësi¹. Në trevat shqiptare të Jugut e më gjerë përcillet një larmi komportimesh shoqërore e ndjehet bashkëveprimi familjar, bashkëveprimi i grupeve të adolehentëve, i brezit të vjetër me brezin e mesëm e të ri, por edhe ai mes çifteve: vëlla – motër, nuse – dhëndër, zonjë – zotëri, politikan – politikane, intelektual – intelektuale, nënë – bijë etj., ku falë sjelljes gjuhësore përcillen qëllimet e reagimet e gjithkahshme e shfaqet imazhi femëror.

Nga studimet e panumërta dalin në pah faktorët biologjikë, psikikë dhe kulturorë të cilët, në një raport shkak-pasojë akoma për t'u studiuar, kanë përcaktuar diferencat gjuhësore të gjinisë². Një i tillë është edhe mekanizmi i emërtimit të ngjyrave, i cili në një këndvështrim sociologjik, në mendësinë shqiptare nuk ka një efekt të fortë stereotipizimi: nëse një mashkull i njej ose jo shumë mirë ngjyrat, nuk gjykohet ose paragjykohet, pra vlerësimi për të mbetet neutral. Në raste të rralla mund të konsiderohet me humor, por asgjë më tepër. Në këndvështrimin gjuhësor shpalosen para nesh dy sisteme konceptimi dhe emërtimi tërësisht të ndryshme.

Hulumtimet për të folurin e imazhin publik femëror kanë qenë përherë ndërdisiplinare³. Në themel të teorisë që zbulon identitetin gjuhësor e shoqëror të individit e, në këtë rast, të femrës, është ideja se jeta jonë shoqërore është një simbiozë veçorish e ndërvarësish, ku asnjëherë nuk duhet të shmangim dinjitetin vetjak e publik⁴.

Literatura botërore këtë gjysmëshekull ofron pikëpamje të ndryshme rreth ndërtimit të korpusit leksikor të ngjyrave në ligjërimin femëror. Pa dashur t'i anashkalojmë këto kontribute po përmendim Lakoff, gjuhëtarën amerikane, e

¹ R. Hudson, *Sociolinguistika*, 123, Tiranë, 2002.

² Shih P. Eckert, *The whole woman: Sex and gender differences in variation*, në "Language Variation and Change", 1, 1989, 245-267.

³ W. Labov, *The intersection of sex and social class in the course of linguistic change* në "Language Variation and Change", 2, 1990, f. 205-254; P. Eckert pohon se të dhënat e shumta në lëmin e diferencave gjinore në ligjërim, sidomos rreth variacionit fonetik, sjellin nevojën që këto studime të marrin edhe drejtime të tjera, *The whole woman: Sex and gender differences in variation*, në "Language Variation and Change", 1, 1989, f. 264.

⁴ R. Hudson, vep. cit. 129.

cila e trajton për herë të parë teorinë e emërimit të ngjyrave dhe sasinë e përdorimit të tyre në ligjërimin femëror të gjuhës angleze, në *Language and woman's place* që në vitin 1973⁵.

Pikëpamjet e Lakoff – pa i kufizuar si pikëpamje thjesht feministe - duket se dëshmojnë më tepër një tendencë stereotipizimi të shoqërisë amerikane, e cila në vetvete përbën një pasojë dhe jo një shpjegim se përse, një maskull etiketohet si: një person që në mënyrë sarkastike po imiton një femër, si homoseksual, dekorues apo njeri i çuditshëm në rastet kur përdor një emërtim shumë specifik për një ngjyrë. Ajo nuk ndalet të shpjegojë strukturën e fjalëformimit të tyre dhe e liston thjesht si një provë më tepër për të vërtetuar tezën, në atë kohë ende të diskutueshme, e ekzistencës së ligjërimin femëror në formën e një niveli a varianti tjetër të gjuhës, apo një regjistër gjuhësor i veçantë apo ndonjë lloj tjetër kategorizimi për atë që më vonë u pranua botërisht si ligjërim femëror. Në fakt, nuk është e mjaftueshme të dallojmë diferencat në të folurin femëror për të pohuar ekzistencën e një ligjërimi të tillë. Duhet saktësuar se në cilin plan ndodhin të tilla diferencime, cilat janë shkaqet kryesore dhe cilat janë qëllimet e ndjekura komunikative ose efektet që prodhohen në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi një përshkrim të plotë të fenomenit pa u ndalur në shfaqjet e tij më të menjëhershme, ndaj dhe në këndvështrimin gjuhësor, diskutimi është shumëplanësh.

Ligjërimi femëror në gjuhën shqipe mbart karakteristika të veçanta në të gjitha sistemet e tij, të cilat teorikisht i thjeshtojmë duke i klasifikuar në regjistra e nivele të ndryshme të gjuhës, porse praktikisht shfaqen qartazi saponis një bashkëbisedim midis femrave me njëra-tjetrën apo me individë të seksit tjetër. Studimet mbi ligjërimin femëror në gjuhën shqipe i janë referuar më së shumti sistemit fonetik e leksikor dhe më pak atij sintaksor⁶. Duke hulumtuar vëmendshëm vërejmë se mënyra sesi i konceptojnë dhe formësojnë ngjyrat femrat në gjuhën shqipe dëshmon edhe një herë se lidhjet midis kulturës/eksperiencës dhe gjinisë reflektohen jo vetëm mbi strukturën e gjuhës dhe nivelet e ndryshme të analizës (veçanërisht në leksik), por edhe mbi mënyrën se si mendojnë, sjelljet shoqërore, vlerësimet dhe pritshmëritë që gjuha kontribuon të ndërtojë dhe të trashëgojë. Gjuha, në fakt, larg të qenit neutrale, ndikon në mënyrë domethënëse tek sistemet simbolike të folësve. “Zgjedhja e mbiemrit është një tregues i një vlerësimi; edhe një qëndrim, prapa të cilit është një mënyrë vështrimi a koncepti të botës”⁷.

⁵ R. Lakoff, *Language and Woman's Place*, “Language in Society”, Vol. 2, No. 1, 1973, f. 45-80.

⁶ Gj. Shkurtaj, *Emografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004.

⁷ Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë, 1999, f. 68-69.

Fjalori i ngjyrave në ligjërimin femëror

Nga një vështrim i përgjithshëm në lirikën tonë popullore, regjistri i emërtimeve të ngjyrave nuk shfaqet shumë i pasur, pasi në të përmendet më së shumti e bardha, e zeza, e kuqja, e argjëndta, vetëm një herë jeshilja dhe e verdha. Edhe në krijimtarinë e Musine Kokalarit, e cila: "...për të dhënë më mirë atmosferën sa më të natyrshme, sa më afër jetës së popullit, zgjodhi dialektin e Gjirokastrës duke e ruajtur atë në disa shfaqje nga më tipiket"⁸, gjejmë disa emërtime ngjyrash si: femërat *e zeza*, duart *e zeza*, atë *të kuq* e atë *të bardh*, *e zeza* fëmilë, burrat *e zes*, *të zezën raki*, *dillë*, *koço-ziu*, *baba-ziu*, *flak e kuqe*, *i zi* kucur, i kish bërë faqet *Baca* (të kuqe), flokë të *verdha*, vashë leshëra *mavrija*, *gushë-kuqe*, kunadhja *leshverdhoj*, e *bardhë* zborë, etj.⁹ Kompozitat dhe ndërtimet e tjera me një emërtim ngjyrë në trup janë të panumërta.

Pyetjet e para që na vijnë natyrshëm në mendje janë: a është vërtet kaq i cunguar ylberi i ngjyrave në mendësinë e femrave të këtyre trevave apo varfëria, shpeshherë e skajshme, ka ndikuar edhe në reduktimin e ngjyrave në kuptimin fillimisht fizik e më pas gjuhësor të fjalës? A mos vallë bota e këtyre folësve ishte vërtet bardhë e zi? Pavarësisht pasigurisë time për t'iu përgjigjur me bindje të plotë këtyre pyetjeve, një fakt është i sigurt dhe i pamohueshëm: duke vështruar vëmendshëm kostumet popullore të kësaj treve, ritet e ndryshme, vargjet popullore emocionalisht tejet të forta, shprehjet në këngë etj., të shfaqet para syve një ansambël i tërë ngjarjesh plot muzikë, ndjenjë e jetë. Emërtimet e ngjyrave mungojnë, por tablotë pikturohen qartë dhe vrullshëm me elemente të tjera gjuhësore.

Megjithatë interesante në ato pak raste ku kemi hasur mbiemra ose emërtesa të tjera të ngjyrave është ndërtimi i tyre, lehtësisht i klasifikueshëm në:

- ***mbiemra të thjeshtë***:

na vjen djepja nga Janina/

me 25 bilbila/

ca *të kuq* e ca *jeshila*,¹⁰

pëllumb *i bardhë*, gjumi *i bardhë*, me faqe *të kuqe*, t' shkoftë *i bardhë* moti!, vend *i blertë*, shtëpi *e murrme*, vapori si dem *i zi*, mollë *e kuqe*, etj.;

- ***mbiemra të prejardhur***: i zbardhuar, dushman i nxirë, i zverdhur (mbiemra cilësues të drejtpërdrejtë)¹¹ etj.;

- ***mbiemra të përbërë*** (kryesisht nga një temë emërore dhe një temë mbiemërore ose dy tema emërore): *faqekuqe*, *luleverdhe*, *buzëburbuqe*, *faqeburbuqe*, *leshverdha trëndelinë*, *leshverdha portokale*, *vetullazeza*,

⁸ D. Shaplo, *Vepra e Musine Kokalarit*, në: "Duke kërkuar të vërtetën dhe humanizmin", Toena, Tiranë, 1999, f. 118.

⁹ M. Kokalari, *Vepra*, Faik Konica, Prishtinë, 2004.

¹⁰ Shih *Lirika popullore* 1, 2, 3, 4, Tiranë.

¹¹ V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastrë, 1999, f. 45.

derëzeza, mandilzeza katran, gushëbardha, pëllumb krahëbardhë, këmishëzi, mustaqeverdhë, orëzi, m'u duk se ish ai/ brekëbardhë e festezi, punëbardhë, shamizezë, leshërabardhë, fatzi, fatzezë, punëziu, sybardhi, sykuqi, faqekuqi, faqeportokalli, gushabardhi, kokërrbardhë etj. Në lirikën popullore këta lloj mbiemrash zenë vendin kryesor si më prodhimitarët.¹²

Në vargjet popullore hasim edhe

- *shumë mbiemra të formuar me anë të konversionit (kryesisht nga emra):* plaka me shami mavi, barku e zemëra pisë, më bëri dyllë, kobure e ergjëndë, rrob e mavisë, bardhushka, leshëra katran, rrobat me mavri i ngjeu...etj.;

- *emra dhe mbiemra që tregojnë ngjyra në shkallë sipërore:* flakë i kuq, gjak i kuq, leshverdha portokale, mandilzeza katran, pis i zi, klllok e vërdhë, dyll e verdhë, etj.

Përsa i përket ndërtimit sintaksor të emërtesave ngjyrë kemi:

- *emrin ose mbiemrin që tregon ngjyrë si elemente të dytë të togfjalëshit:* rrobat e kuqe, pëllumb i bardhë, fat i bardhë, gjumë i bardhë, etj.;

- *emra ose mbiemra që emërtojnë ngjyra si elemente të parë të togfjalëshit* (në këtë rast vlera stilistikore është qartësisht e dukshme)¹³: *të zestë shqiptarë, e zeza nënë, të zezatë dhëntë e mia etj.*

Me zhvillimin e vrullshëm, në të cilin të gjithë jemi përfshirë duket se ngjyrat kanë gjetur edhe përdorim më të gjerë.

Një nga ngjyrat që haset më dendur dhe që gëzon edhe privilegjin e të pasurit edhe më tepër nuanca dhe emërtime në ligjërimin femëror është *e kuqja*: në fakt, nëse për një mashkull ngjyra e kuqe mbetet thjesht e kuqe, krejt ndryshe konceptohet e më pas emërtohet nga një femër. Ajo gjithmonë do të përpiqet që ta saktësojë apo ta klasifikojë sipas intensitetit të saj në: e kuqe gjaku, e kuqe luleshege, e kuqe koral, e kuqe e zjarrtë, e ndezur, e vjetër, e zbehtë, e kuqe tulle, e kuqe gjethe qepe, e kuqe paparun, e kuqe lafshë-kokoshi, e kuqe vezë e pashkës, e kuqe karamel, qershi, mjaltë, karotë, trëndafili, çiklamin, ngjyrë speci, e purpurt, vishnje, ngjyrë kanelle etj.

E verdha: e verdhë limoni, ngjyrë veje, mustardë, e verdhë e hapur, e ndezur, e verdhë e mbyllur, ngjyrë pjepri, ngjyrë dheu, pana, neon, fosfor, e venitur, floriri, etj.;

Jeshile: ngjyrë bari, bizele, preshi, kokë rosaku, zhuzhun/zhizhing, ngjyrë ulliri, ngjyrë shpendre, ushtarake;

Blu: e ëmbël, blu-qielli, blu-deti, e errët, e zbardhur, gurkali;

Rozë: ngjyrë bebe, e mbyllur, e hapur, pink (ang);

Kafe: ngjyrë ndryshku, ngjyrë arre¹⁴, ngjyrë verriu (për shkak të pemës së verriut), ngjyrë uthulle, ngjyrë tulle, ngjyrë gruri, kapuçino etj.;

¹² Shih *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995, f. 199.

¹³ Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, vep. cit.

Fjalori i ngjyrave në ligjërimin femëror

Gri: ngjyrë hiri, gushëpëllumbi, ngjyrë plumbi, metalixato, ngjyrë sermi, gri-miu etj.;

Lejla: ngjyrë manushaqe, ngjyrë ashashli (bashkimi i të kuqes me blu-në), ngjyrë shpatëz - lejla e hapur, vjollcë;

Bezhë: ngjyrë lajthie, ngjyrë gruri etj.

Interesant shfaqet edhe ndërtimi i *shkallës sipërore* të këtyre mbiemrave: *bus i bardhë, akull i bardhë, sterrë i zi, pis i zi, skrrrop i zi, kapne e zezë, dyllë i verdhë, bac e kuqe, flakë i kuq, ahëll/shumë, coho/e ndezur* etj.

Dukuri interesante është edhe *prania e huazimeve, kryesisht greke* që emërtojnë ngjyra (për shkaqe tashmë të njohura gjeografike): e di zemëra *mavria, prasino* (e gjelbër), *koqino* (e kuqe). Në ligjërimin femëror ndihen gjurmët e marrëdhënieve historiko-kulturore mes popullit shqiptar e popujve fqinj, dallohet shtresa e dukurive gjuhësore anase, por edhe një shtresë elementesh të huaja¹⁵.

Disa nga këto emërtime si çdo kategori tjetër e gjuhës me kalimin e kohës kanë fituar përdorime të figurshme dhe ndërtime interesante: *mavri me bojë, mavroqellë me bojë, katran me bojë*, por në të njëjtën kohë, gjatë mbledhjes së këtyre fjalëve vihet re mungesa e mbiemrave të formuar nga emri *bojë* – bojëgrurë, bojëkafe etj.

Sigurisht që përtej ndikimit të pastër të një ndryshoreje të vetme siç është gjinia e folësve, ligjërimi femëror nuk mund të perceptohet veçse si rezultat i ndikimit të disa faktorëve së bashku: “Seksi shfaqet tërësisht i filtruar nga pozita shoqërore dhe lidhja me variacionin gjuhësor krijohet nga statusi dhe roli i folësit, pra i grave në shoqëri e nga aktiviteti shoqëror që lidhet me to¹⁶.

Nga sa pamë më sipër mund të themi se zhvillimi i emërtimeve të ngjyrave në ligjërimin femëror ka njohur dy drejtime:

- *diakronik*: shumë emërtime ngjyrash përdoren vetëm nga gra të moshës mbi 50 vjeç dhe dalëngadalë përdorimi i tyre po shuhet (p.sh. ngjyrë gjethe qepe, ngjyrë arre, paparun, ashashli etj.) e të tjera të reja –sidomos huazime nga gjuhë të huaja – përdoren vetëm nga folëset e reja;

- *sinkronik*: në gjendjen aktuale vërehet dendur prirja e formimit të ngjyrave të ndërmjetme me anë të kompozitave, tendenca për të përdorur emrin në vend të ngjyrës me të cilën identifikohet (me anë të konversionit) dhe gjithashtu përdorimi në këto treva i huazimeve kryesisht greke, por jo vetëm: *aspro* (e bardhë), *prasino* (e gjelbër), *mavro* (e zezë), *nero-blu, kapuçino, neon* etj.

¹⁴ Nga zierja e gjetheve të arrës përftohej ngjyra kafe e hapur me të cilën lyheshin flokët e grave ndërsa nga zierja e lëvores së arrës përftohet ngjyra kafe e errët.

¹⁵ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2004, f. 197.

¹⁶ G. Berruto, *Fondamenti di sociolinguistica*, Laterza, 2011, f. 84.

Nga pikëpamja leksiko-semantike emrat që tregojnë ngjyra rrjedhin më së shumti nga lulet, frutat, ushqimet, shpendët, pra nga fusha leksikore e lidhur më tepër me jetën e gruas dhe aktivitetin e saj të përditshëm.

Përfundime

Shpalosja e menjëhershme e diferencës seksuale në ligjërim, e thyen iluzionin e një biseduesi thjesht formal duke nxjerrë në dritë nyjen e pandashme midis psikofizikes dhe arsyes, duke zbuluar dimensione të reja të kuptimit, lidhje midis gjuhësisë dhe fushave të reja të dijes.

Fusha leksikore e mbiemrave në ligjërimin femëror përbën një pasuri, e cila pashtershmërisht buron dhe krijon leksema të reja dhe forma gjuhësore gjithmonë të freskëta. Dinamiciteti i këtij zhvillimi është tejet i vrullshëm saqë një fjalë ndonjëherë është e vështirë ta fiksosh si në një aparat fotografik në një stad të caktuar. Dëshmi e këtij procesi të pandërprerë drejt përsosjes dhe lëmimit të këtij ligjërimi ndër vite janë vargjet lirike popullore të femrave dhe krijimtaria artistike e shkrimtareve të ndryshme.

Sipas Lakoff: “Gjuha na përdor po aq sa ne e përdorim atë. Ashtu si zgjedhjet tona të shprehjes udhëhiqen nga mendimet që ne duam të shprehim, në të njëjtën formë ajo çka ne ndjejmë në botën reale udhëheq mënyrën sesi ne shprehemi rreth saj¹⁷.”

BIBLIOGRAFI

- D. Shaplo, *Vepra e Musine Kokalarit*, në: “Duke kërkuar të vërtetën dhe humanizmin”, Toena, Tiranë, 1999.
- G. Berruto, *Fondamenti di sociolinguistica*, Laterza, 2011.
- Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë 1995.
- GJ. Shkurtaj, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004.
- Lirika popullore 1, 2, 3, 4*, Tiranë.
- M. Kokalari, *Vepra*, Faik Konica, Prishtinë, 2004.
- P. Eckert *The whole woman: Sex and gender differences in variation*, në *Language Variation and Change*, 1, 1989.
- R. Hudson, *Sociolinguistika*, 123, Tiranë, 2002.
- R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2004.
- R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2004.
- R. Lakoff, *Language and Woman's Place*, në *Language in Society*, Vol. 2, No. 1, 1973.
- V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prepjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999.
- Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë, 1999.
- W. Labov, *The intersection of sex and social class in the course of linguistic change në Language Variation and Change*, 2, 1990.

¹⁷ R. Lakoff *Language and Woman's Place*, *Language in Society*, Vol. 2, No.1 1973, f. 45.